



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 3.7.2024

Dokument parlamentar

RAPORT

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR PËR
VITIN 2023 DHE MIRATIMIN E PROJEKTREZOLUTËS PËRKATËSE**

I. Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, bazuar në nenin 103, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës, mori në shqyrtim raportin vjetor të veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor, për vitin 2023 në mbledhjet e tij të datave 7 qershor dhe 3 korrik 2024.

Të pranishëm në seancën dëgjimore të datës 7 qershor për të bërë prezantim e raportit vjetor, si dhe për t'ju përgjigjur pyetjeve të deputetëve ishte Znj. Naureda Llagami, Kryetare e këtij Këshilli dhe përfaqësues të tjerë të institucionit .

Komisioni caktoi relator për këtë çështje Z. Klevis Xhoxhi.

II. Baza ligjore

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në zbatim të nenit 82, të ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, ka paraqitur raportin vjetor për punën e tij për vitin 2023, pranë Kuvendit të Shqipërisë.

Komisioni përgjegjës, bazuar në nenin 103, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, organizon seancë dëgjimore për shqyrtimin e raportit dhe në përfundim të diskutimeve, harton një projektrezolutë të vlerësimit të punës së institucionit, të cilën ia paraqet seancës plenare. Miratimi i kësaj projektrezolute kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1, e Rregullores së Kuvendit.

III. Qëllimi

Në përmbushje të një prej detyrave kryesore të tij, atë të kontrollit parlamentar, Kuvendi i Shqipërisë, bazuar në nenin 103, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, organizon seancë dëgjimore për shqyrtimin e raportit vjetor të institucionit të pavarur dhe, në përfundim të diskutimeve, harton një projektrezolutë të vlerësimit të punës së institucionit, të cilën e paraqet në seancë plenare. Projektrezoluta përfshin vlerësime dhe konstatime lidhur me veprimtarinë e institucionit të pavarur, në rastin konkret të Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2023, si dhe rekomandime, të cilat institucioni i pavarur duhet t'i ketë në konsideratë gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjatë vitit 2024.

IV. Diskutimi në Komision

Kryetarja e KLGJ-së në fjalën e saj paraqiti drejtimet kryesore të veprimtarisë së institucionit gjatë vitit të mëparshëm si dhe prioritetet kryesore të tij për vitin 2024.

Relatori paraqiti një informacion me vlerësimet e tij për veprimtarinë njëvjeçare të këtij institucioni si dhe disa rekomandime për përmirësimin e punës gjatë vitit në vazhdim.

Gjatë diskutimeve, anëtarët e Komisioni vlerësuan punën e kryer nga institucioni gjatë vitit 2023, e cila ka rezultuar në përmbushje të kërkesave të rezolutës së mëparshme të Kuvendit, si dhe në zbatim të plotë të rekomandimeve të raporteve të organizmave ndërkombëtar. Gjithashtu, Komisioni shprehu angazhimin për rritjen e bashkëpunimit me KLGJ-në, duke ofruar mbështetjen e tij maksimale ndaj këtij institucioni.

Komisioni vlerësoi veprimtarinë e Inspektoratit për sa i takon:

- Zhvillimin e 80 mbledhjeve plenare dhe miratimin e 743 vendimeve, nga të cilat 27 akte nënligjore, 506 akte individuale, 162 akte kolektive, 47 akte rregulla të brendshme dhe 1 udhëzim.
- Implementimin dhe zbatimin e Hartës së Re Gjyqësore, përmes hartimit të një pakete prej 60 aktesh administrative dhe individuale.
- Plotësimin e vakancave në Gjykatën e Lartë me 19 anëtarë përmes procedurës së ngritjes në detyrë të magjistratëve.
- Unifikimin e standardeve të administrimit të brendshëm gjyqësor përmes miratimit të rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë nëpër gjykata.
- Miratimin e kuotave për ndihmës ligjorë dhe magjistrat “profili gjyqtar” për vitin akademik 2023- 2024 në Shkollën e Magjistraturës.
- Rritjen e kapaciteteve profesionale për gjyqtarët dhe stafin administrativ, nëpërmjet trajnimit të 209 gjyqtarëve që ushtrojnë efektivisht detyrën, 103 nëpunës civilë gjyqësorë dhe 15 punonjës të KLGJ-së, në bashkëpunim të ngushtë me Shkollën e Magjistraturës, projektet e asistencës së huaj, dhe Shkollën Shqiptare të Administratës Publike.

Në mbledhjen e datës 3 korrik, Komisioni u mbledh për të shqyrtuar draftin e Projektrezolutës së përgatitur nga Relatori, e cila pasqyron të dhënat e raportuara për aktivitetin e KLGJ-së, si dhe çështjet e diskutuara në seancën dëgjimore të datës 7 qershor.

V. Përfundime

Në përfundim të mbledhjes, Komisioni e miratoi Projektrezolutën me votat pro të shumicës së anëtarëve të pranishëm në mbledhje dhe ia paraqet për miratim seancës plenare, sipas variantit që i bashkëlidhet këtij raporti.

RELATOR

KRYETARE

Klevis XHOXHI

Klotilda BUSHKA